

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT



Programi mësimor

Shkencat natyrore për klasën V

Shkup, 2021

TË DHËNAT THEMELORE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

Lënda mësimore	Shkencat natyrore
Lloji/kategoria e lëndës mësimore	I detyrueshëm
Klasa	V (e pestë)
Temat/fushat në programin mësimor	<ul style="list-style-type: none"> • Veçoritë natyrore-gjeografike të kontinenteve • Cikli jetësor i bimëve me lule • Organizmat e gjallë dhe mjedisi jetësor • Përzierjet • Drita dhe hijet
Numri i orëve	2 orë në javë/72 orë në vit
Mjetet dhe pajisjet	<ul style="list-style-type: none"> • Hamer, letër me ngjyra, letër kollazhi, markera, gërshërë, kompjuter, projektor, telefon celular (aplikacione); • Hartë gjeografike e botës, hartë gjeografike e kontinenteve, glob, hartë memece e botës; • Material i ilustruar për: relievin, vullkanet, tërmetet, mbrojtjen/vetëmbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore, llojet e shkëmbinjve, atmosfera, elementet meteorologjike dhe dukuritë meteorologjike, vendndodhja gjeografike e florës dhe faunës, ujërat në tokë; • Plastelinë, argjilë, brumë me mielli, uthull, piper të kuq, sodë bikaroboni; • Ngjitës, gota plastike, tokë, fara fasuleje, kungull, thjerrëza, misër, grurë, material lulesh natyral, model lulesh gjipsi ose plastik, model gjipsi për frytnimin e bimës, modeli gjipsi për mbirjen së farës, kuti kartoni, rërë, argjilë, ngjyra tempera, poster letër, hamer, kartela me foto kafshësh, kartona të ilustruara në dy ngjyra me foto kafshësh dhe nocione, letër me përmasa 10 x 10 cm, vazelinë; • Sita me vrima të madhësive të ndryshme, gota, lugë, hinka, letër filtri, shufra qelqi, unaza metalike për hinkë, trekëmbësh, ngrohës (resho, llambë vajguri), enë porcelani, rrjeta rezistente ndaj zjarrit, trekëmbëshe metalike, magnet, kripë, sheqer, kafe, kakao, miell, erëza të përziara, oriz, fasule, shkumës, rërë, copëza të metalit, ashkla druri, ujë, vaj, ujë të gazuar / lëng të gazuar, alkool, uthull; • Qiri, llambë, llambë celulari, bateri dore, prizëm xhami, pasqyrë e sheshtë, lazer, plastikë e tejdukshme, filxhan/kavanoz qelqi, shami, shkumës, metër, luksmetër;

	<ul style="list-style-type: none"> Fletë pune (sipas tekstit/doracakut);
Normativi për kuadrin mësimor	<p>Mësimdhënien nga shkencat natyrore në klasën e pestë mund ta realizojë person që ka kryer studimet për:</p> <ul style="list-style-type: none"> biologji, drejtimi arsimor, VII/1 ose 240 SETK kredi të fituara kimi, drejtimi arsimor, VII/1 ose 240 SETK kredi të fituara fizikë, drejtimi arsimor, VII/1 ose 240 SETK kredi të fituara gjeografi, drejtimi arsimor, VII/1 ose 240 SETK kredi të fituara studime dylëndore biologji-kimi, VII/1 ose 240 SETK kredi të fituara studime dylëndore fizikë-kimi, VII/1 ose 240 SETK kredi të fituara biologji, drejtim tjetër joarsimor, VII/1 ose 240 SETK kredi të fituara dhe përgatitje pedagogjiko-psikologjike dhe metodologjike në institucion të akredituar të arsimit të lartë; kimi, drejtim tjetër jo arsimor, VII/1 ose 240 SETK kredi të fituara dhe përgatitje pedagogjiko-psikologjike dhe metodologjike në institucion të akredituar të arsimit të lartë; fizikë, drejtim tjetër jo arsimor, VII/1 ose 240 SETK kredi të fituara dhe përgatitje pedagogjiko-psikologjike dhe metodologjike në institucion të akredituar të arsimit të lartë;

LIDHSHMËRIA ME STANDARDET NACIONALE

Rezultatet e të nxënit të paraqitura në programin mësimor shpiejnë drejt përvetësimit të kompetencave vijuese të përfshira në fushën **Matematikë dhe shkenca natyrore** nga Standardet nacionale:

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe/ose mund:</i>	
III-A.28	të përdorë njohuritë themelore shkencore për të shpjeguar natyrën;
III-A.29	të shqyrtojë dhe të zgjedhë ide, të vëzhgojë, të parashikojë dhe të bëjë supozime (hipoteza), të mbledhë dhe të vlerësojë provat, të kontrollojë parashikimet, të planifikojë, të organizojë dhe të kryejë kërkime, të regjistrojë, të përpunojë, të analizojë dhe të paraqesë rezultate, të evaluojë dhe të diskutojë konkluzionet;
III-A.30	të organizojë dhe prezantojë të dhënat kuantitative në formë tabelare, grafike, diagrame dhe skica dhe të interpretojë të dhëna nga fusha të ndryshme, të paraqitura në mënyra të ndryshme;
III-A.31	të kryejë eksperimente të thjeshta, duke përdorur pajisje laboratorike dhe kimikate të përshtatshme, të bëjë matje, duke përdorur pajisje dhe instrumente të përshtatshme;

III-A.32	të vlerësojë rreziqet në laborator dhe të njohë dhe zbatojë masat paraprake dhe rregullat për punën në laborator;
III-A.33	të hulumtojë dhe diskutojë ndikimin e shkencës, teknologjisë dhe aktiviteteve njerëzore në mjedisin jetësor;
III-A.34	të dallojë dhe klasifikojë substancat dhe të lidh përbërjen e tyre me vetitë e tyre;
III-A.43	të identifikojë dhe hulumtojë dukuritë në natyrën e gjallë dhe jo të gjallë;
III-A.46	të përshkruajë dhe të analizojë proceset themelore fiziologjike (rolin dhe funksionin e tyre) që ndodhin në organizmat e gjallë dhe t'i prezantojë ato me figura, skema, diagrame dhe ekuacione;
III-A.47	të zbatojë njohuritë për proceset themelore jetësore që ndodhin në nivel të organizmave për të përmirësuar cilësinë e jetës së tyre;
III-A.51	të shpjegojë ndërveprimin midis njeriut dhe mjedisit dhe të identifikojë ndikimet pozitive dhe negative të njeriut në mjedisin jetësor;
III-A.52	të kuptojë rëndësinë dhe nevojën për zhvillim të qëndrueshëm dhe të analizojë në mënyrë kritike situatat në të cilat ka konflikt interesi ndërmjet nevojës për zhvillim ekonomik dhe teknologjik dhe mbrojtjes së mjedisit jetësor;
III-A.54	të shpjegojë dukuritë fizike dhe të përdorë konceptet shkencore në jetën e përditshme;
III-A.58	të analizojë dhe grafiksht të paraqesë dukuritë e dritës duke përdorur një rreze drite;
III-A.63	të identifikojë dhe krahasojë veçoritë gjeografike të kontinenteve, rajoneve dhe shteteve në botë;
III-A.65	të lidhë karakteristikat gjeografike të rajoneve me vendndodhjen e kafshëve të egra;
III-A.66	të gjejë informacion për karakteristikat e zonave gjeografike të paraqitura në harta dhe përgatit skica për paraqitjen e zonave gjeografike me karakteristikat e tyre.
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon që:</i>	
III-B.5	kurioziteti, sistematika dhe inovacioni janë çelësi për zhvillimin e mendimit kërkimor - shkencor;
III-B.7	ngrohja globale çon në fatkeqësi natyrore me pasoja për botën e gjallë dhe jo të gjallë të të gjithë planetit;
III-B.8	çdo individ është përgjegjës për ruajtjen e mjedisit natyror në mjedisin e afërt dhe më gjerë dhe që duhet të zhvillojë ndërgjegjësimin ekologjik dhe të veprojë në drejtim të mbrojtjes dhe qëndrueshmërisë së mjedisit;

Programi mësimor përfshin gjithashtu kompetencat përkatëse në fushat e mëposhtme: **Shkrim-leximi gjuhësor, Shkrim-leximi digjital, Zhvillimi personal dhe social, Shoqëria dhe kultura demokratike dhe Teknika, teknologjia dhe sipërmarrësia.**

<i>Nxënësi/nxënësjja di dhe mund:</i>	
I-A.3	të zhvillojë dialog kritik dhe konstruktiv, duke shprehur me argumente pikëpamjet e tij/saj;
I-A.10	të kuptojë përmbajtjet e paraqitura vizualisht (diagrame, tabela dhe grafikë, ilustrime, animacione etj.), të jetë në gjendje të veçojë, analizojë, vlerësojë dhe përmbledhë përmbajtjet e paraqitura vizualisht dhe t'i shpjegojë ato (me shkrim dhe me gojë);
I-A.12	të përdorë informacione nga burime dhe media të ndryshme dhe t'i qasen në mënyrë kritike atyre, duke marrë parasysh burimin, kontekstin, qëllimin dhe besueshmërinë e informacionit të paraqitur;
IV-A.2	të vlerësojë se kur dhe në çfarë mënyre për zgjidhjen e një detyre/problemi është i nevojshëm dhe efektiv përdorimi i TIK-ut;
IV-A.5	të përcaktojë se çfarë informacioni i nevojitet atij/asaj, të gjejë, të zgjedhë dhe të shkarkojë të dhëna digjitale, informacione dhe epërmbajtje;
IV-A.8	në mënyrë të sigurt dhe të përgjegjshme të përdorë përmbajtjet dixhitale, rrjetet edukative dhe sociale dhe retë digjitale;
V-A.4	t'i vlerësojë aftësitë dhe arritjet e tij/saj (përfshirë pikat e forta dhe të dobëta) dhe mbi atë bazë të përcaktojë përparësitë që do të mundësojnë zhvillimin dhe përparimin e tij/saj;
V-A.6	të vendosë qëllime për mësim dhe vetëzhvillim dhe të punojë për të tejkaluar sfidat që dalin gjatë rrugëtimit drejt arritjeve të tyre;
V-A.7	t'i përdorë përvojat e veta për të lehtësuar mësimin dhe për të rregulluar sjelljen personale në të ardhmen;
V-A.8	të organizojë kohën e tij/saj në atë mënyrë që t'i mundësojë atij/asaj të arrijë në mënyrë efikase dhe efektive qëllimet e vendosura dhe të kënaqë nevojat e veta;
V-A.13	të komunikojë me të tjerët dhe për t'u paraqitur në mënyrë të përshtatshme për situatën;
V-A.14	të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të reagojë në mënyrë të përshtatshme duke treguar ndjeshmëri dhe mirëkuptim për të tjerët dhe duke shprehur shqetësimet dhe nevojat e veta në një mënyrë konstruktive;
V-A.15	të bashkëpunojë me të tjerët në arritjen e qëllimeve të përbashkëta duke ndarë pikëpamjet dhe nevojat e veta me të tjerët dhe duke marrë parasysh pikëpamjet dhe nevojat e të tjerëve;
V-A.17	të kërkojë informatë kthyesë dhe mbështetje për veten, por gjithashtu ta kthejë informatën në mënyrë konstruktive dhe mbështetëse në dobi të të tjerëve;
V-A.18	të hulumtojë, të bëjë pyetje përkatëse, në mënyrë që të identifikojë problemet, të analizojë dhe vlerësojë informacionin dhe propozimet dhe të verifikojë supozimet;
V-A.19	të propozojë, të shqyrtojë mundësi të ndryshme dhe të parashikojë pasojat në mënyrë që të nxjerrë konkluzione dhe të marrë vendime racionale;
V-A.21	të analizojë, të vlerësojë dhe të përmirësojë mësimin e vet;
VI-A.3	të formulojë dhe të argumentojë pikëpamjet e veta, t'i dëgjojë dhe analizojë pikëpamjet e njerëzve të tjerë dhe të silltet me respekt, edhe kur ata nuk janë dakord;
VI-A.5	t'i kuptojë ndryshimet midis njerëzve për çfarëdo baze (gjinia dhe përkatësia etnike, moshë, aftësitë, statusi shoqëror etj.);
VI-A.6	ta njohë praninë e stereotipave dhe paragjyqimeve të vetja dhe të tjerët dhe të kundërshtojë diskriminimin;
VI-A.18	të analizojë në mënyrë kritike kërcënimet nga zhvillimi i pabalancuar ndaj mjedisit dhe të kontribuojë aktivisht në mbrojtjen dhe promovimin e tij.

VII-A.1	të lidh njohuritë nga shkencat me zbatimin e tyre në teknikë dhe teknologji dhe në jetën e përditshme;
VII-A.9	të merr pjesë aktive në punën ekipore sipas rregullave të pranuara më parë dhe me respekt të vazhdueshëm për rolin dhe kontributin e të gjithë anëtarëve të ekipit.
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon që:</i>	
IV-B.1	shkrim-leximi digjital është i nevojshëm për jetën e përditshme-lehtëson të mësuarit , jetën dhe punën, kontribuon në zgjerimin e komunikimit, krijimtarisë dhe inovacionit, ofron mundësi të ndryshme për argëtim;
V-B.3	arritjet dhe mirëqenia personale kryesisht varen nga puna që ai/ajo investon dhe rezultatet që ai/aji arrin;
V-B.4	çdo veprim që ai/ajo ndërmerr ka pasoja për të dhe/ose për mjedisin e tij/saj;
V-B.7	iniciativa, këmbëngulja, qëndrueshmëria dhe përgjegjësia janë të rëndësishme për zbatimin e detyrave, arritjen e qëllimeve dhe tejkalimin e sfidave në situatat e përditshme;
V-B.8	ndërveprimi me të tjerët është i dyanshëm - ashtu si ai/ajo ka të drejtë t'u kërkojë të tjerëve që t'i mundësojnë të kënaqet me interesat dhe nevojat e tij/saj, ashtu ai/ajo ka përgjegjësinë t'u japë hapësirë të tjerëve për të kënaqur. interesat dhe nevojat e tyre;
V-B.9	kërkimi i informatës kthyesë dhe pranimi i kritikave konstruktive çon në përparimin personal në nivel individual dhe shoqëror;
V-B.10	mësimi është një proces i vazhdueshëm që nuk përfundon në shkollë dhe nuk kufizohet vetëm në arsimin formal;
VI-B.9	çdo qytetar duhet të marrë përgjegjësinë për ndryshimet në natyrë të shkaktuara nga aktivitetet njerëzore;
VI-B.10	njohja e historisë dhe gjeografisë ofron një kuptim më të mirë të botës në të cilën jetojmë;
VII-B.5	burimet nuk janë të pakufizuara dhe duhet të përdoren me përgjegjësi.

REZULTATET E TË NXËNIT

Tema: **VEÇORITË NATYRORE-GJEOGRAFIKE TË KONTINENTEVE**

Gjithsej: **22 orë**

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:

1. përshkruajë pozitën gjeografike, kufijtë dhe madhësinë e kontinenteve dhe t'i tregojë ato hartën gjeografike;
2. shpjegojë forcat natyrore të brendshme dhe të jashtme që formojnë relievin dhe të përcaktojë llojet e relievit;

3. përshkruajë përbërjen e atmosferës, të dallojë elementët meteorologjikë dhe dukuritë meteorologjike dhe të përshkruajë brezat e nxehtësisë dhe ndikimin e klimës në shpërndarjen e florës dhe faunës;
4. dallojë dhe lidhë termat Det Botëror, ujë nëntokësor dhe ujë sipërfaqësor dhe të shpjegojë domethënien e karakteristikave natyrore-geografike për ekzistencën e jetës në planetin Tokë.

Përmbajtjet (dhe nocionet)	Standardet për vlerësim
<ul style="list-style-type: none"> • Pozita gjeografike e kontinenteve (kontinent, oqean, pozitë gjeografike, ekuator, meridiani i Griniçit, hemisferë veriore, hemisferë jugore, hemisferë lindore, hemisferë perëndimore, kufijtë, madhësia, Azia, Afrika, Amerika e Veriut, Amerika e Jugut, Antarktida, Evropa, Australia me Oqeaninë) 	<ul style="list-style-type: none"> • Numëron kontinentet sipas madhësisë së tyre; • Përshkruan pozitën gjeografike të çdo kontinenti në lidhje me ekuatorin dhe meridianin e Griniçit dhe në raport me kontinentet dhe oqeanet e tjera; • Përshkruan në hartën gjeografike kufijtë e kontinenteve;
<ul style="list-style-type: none"> • Relievi i kontinenteve (reliev, forca të brendshme, lëvizje tektonike, male, lugina, forca të jashtme, erozion, akumulim, vullkan, shpërthim, llavë, magmë, shpërthim vullkanik, krater, kanal vullkanik, gejzer, tërmet, hipoqendër, epiqendër, cunami, shkëmbinj të shtresuar, shkëmbinj vullkanik, reliev vullkanik, reliev detar, reliev liqenor, reliev akullnajor, reliev shkretinor) 	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon forcat natyrore të brendshme dhe të jashtme dhe ndikimin e tyre në formimin e relievit; • Shpjegon formimin e vullkaneve dhe elementet e tyre; • Shpjegon shfaqjen e tërmeteve dhe elementet e tyre; • Emërton lloje të ndryshme shkëmbinjsh dhe shpjegon se si formohen; • Emërton lloje të ndryshme të relievit dhe bën një lidhje midis llojit të relievit dhe forcës natyrore që e formon atë; • Identifikon dhe shpjegon format kryesore të relievit të kontinenteve;
<ul style="list-style-type: none"> • Atmosfera • Klima e kontinenteve (atmosfera, oksigjen, azot, dioksidi i karbonit, avuj të ujit, pluhur, troposferë, stratosferë, ozonosferë, jonosferë, ekzosferë, ngrohja globale, temperatura e ajrit, shtypje e ajrit/atmosferike, lagështi e ajrit, termometër, barometër, psihrometër, dukuri meteorologjike, erë, rreshje, mjegull, 	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan përbërjen, ndarjen, ngrohjen dhe rëndësinë e mbështjellësit ajror/atmosferës; • Shpjegon elementet meteorologjike: temperaturën e ajrit, shtypjen atmosferike/ajrore, lagështinë e ajrit dhe i lidh ato me instrumente matëse përkatëse. • Shpjegon dukuritë meteorologjike: era, reshjet, mjegulla; • Numëron dhe shpjegon faktorët klimatikë dhe bën një lidhje midis brezave të nxehtësisë (brezi i nxehtë, brezi verior dhe jugor mesatar i nxehtësisë, brezi verior dhe jugor i ftohtë) dhe stinëve të vitit; • Jep shembuj të florës dhe faunës që i banojnë kontinentet nëpër breza

<p>erëtragues, shimatës, faktorë klimatikë, ekuator, lartësi, reliev, breza termikë, pyje ekuatoriale të shiut, savanat, stepat, shkretëtira, pyjet gjetherënëse, pyjet halore, kullotat, taiga, tundra)</p>	<p>të ndryshëm të nxehtësisë;</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Hidrografia e kontinenteve <p>(Deti Botëror, oqeani, Oqeani Pacifik/Paqësor, Oqeani Atlantik, Oqeani Indian, Oqeani Arktik, Oqeani Jugor, det, valë, rryma detare, baticë, zbatice, ujëra nëntokësore, ujëra sipërfaqësore, burim, lumë, shtrat lumi, rjedha e lumit), prurje, gjarpërime, ujëvarë, rrjet lumi, pellg lumi, gropë, liqen, pellg liqeni)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Dallon dhe lidh termat Deti Botëror, ujë nëntokësor dhe ujë sipërfaqësor; • Numëron oqeanet sipas madhësisë së tyre dhe përcakton detet më të mëdha në hartën gjeografike; • Shpjegon origjinën dhe rrjedhën e ujërave nëntokësore dhe burimeve dhe bën një lidhje ndërmjet tyre; • Numëron dhe përshkruan elementet e një pellgu lumi dhe liqeni dhe tregon në hartën gjeografike lumenjtë dhe liqenet më të mëdhenj në kontinente.
<p>Shembuj të aktiviteteve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nëpërmjet paraqitjes vizuale nxënësit njihen me kontinentet dhe me ndihmën e hartës gjeografike, më pas, të ndarë në grupe, i krahasojnë dhe i renditin sipas madhësisë; • Nëpërmjet paraqitjes vizuale nxënësit njihen me vendndodhjen e kontinenteve, me pozitën e tyre gjeografike në raport me ekuatorin dhe meridianin e Griniçit, si dhe në raport me kontinentet dhe oqeanet e tjera. Më pas ata demonstrojnë vendndodhjen e kontinenteve në hartën gjeografike dhe diskutojnë pozitën e tyre gjeografike në lidhje me anët e botës, ekuatorin dhe meridianin e Griniçit; • Nxënësit, të ndarë në grupe të vogla/dyshe, plotësojnë hartat memece duke përdorur hartën gjeografike dhe kështu përshkruajnë kufijtë dhe madhësinë e kontinenteve; • Nxënësit ndjekin një paraqitje vizuale nëpërmjet së cilës njihen me ndryshimin midis forcave natyrore të brendshme dhe të jashtme. Më pas ata diskutojnë ndikimin e forcave natyrore në formimin e relievit të kontinenteve; • Nxënësit nëpërmjet prezentimit vizual njihen me vullkanet, mënyrën se si krijohen dhe elementet e tyre. Më pas, të ndarë në grupe të vogla/dyshe, ata bëjnë një 3D model të një vullkani nga materiale të ndryshme (plastelinë, argjilë, brumë) dhe simulojnë një shpërthim vullkanik (uthull, piper i kuq, sodë bikarbonë); • Nxënësit nëpërmjet prezentimit vizual njihen me atë se si shfaqjen tërmetet dhe elementet e tyre. Më pas, të ndarë në grupe, ata simulojnë tërmetet dhe pasojat e tërmeteve në ndërtesa. Duke vepruar kështu, ata përdorin karton për të vizatuar rathë koncentrikë dhe përdorin kube për të mbledhur objekte të shumta që i renditin në rathë të ndryshëm në karton. Duke u tundur me kohëzgjatje të ndryshme dhe me intensitet të ndryshëm në rrethin qendror nga ana e poshtme e kartonit (epiqendra dhe hipoqendra) përcaktojnë se çfarë ndodh me objektet e vendosura në rathë të ndryshëm. Përveç kësaj, ata mund të bëjnë një model të një seizmografi që do të 	

regjistrojë valët seizmike;

- Mësimdhënësi nëpërmjet prezentimit vizual i njofton nxënësit me llojet e ndryshme të shkëmbinjve, formimin dhe vetitë e tyre. Nxënësit, të ndarë në grupe, marrin një mostër të shkëmbit, përcaktojnë llojin dhe vetitë e tij dhe ua prezantojnë të tjerëve atë që kanë përcaktuar;
- Nxënësit nëpërmjet prezentimit vizual njihen me llojet e ndryshme të relievit, karakteristikat e tyre dhe forcat natyrore që i formojnë. Çdo nxënës plotëson një fletë pune në të cilën ai njih dhe emërton lloje të ndryshme relievi;
- Nxënësit, të ndarë në grupe të vogla, bëjnë postera me forma reliev nga kontinente të ndryshme dhe diskutojnë për llojet e relievit të pranishëm në kontinentin "e tyre". Ata ua prezantojnë të tjerëve atë që kanë mësuar. Në një diskutim të hapur, ata krahasojnë format e relievit të të gjitha kontinenteve;
- Nxënësit, të ndarë në grupe të vogla, kërkojnë nëinformata në internet mbi mbulesën ajrore të Tokës (përbërja, ndarja, ngrohja). Secili grup përgatit një prezantim të shkurtër të asaj që ka zbuluar dhe merr komente nga mësimdhënësi në lidhje me rëndësinë e të dhënave të paraqitura. Në fund, ka një diskutim të hapur për rëndësinë e mbulesës ajrore për botën e gjallë në planetin tokë;
- Nëpërmjet prezantimit vizual nxënësit njihen dhe diskutojnë ndryshimet midis elementeve meteorologjike dhe dukurive meteorologjike. Çdo nxënës plotëson një fletë pune në të cilën njih, emërton dhe lidh lloje të ndryshme të elementeve meteorologjike dhe dukurive meteorologjike;
- Nxënësit, të inkurajuar nga prezantimi vizual, diskutojnë faktorë të ndryshëm klimatik dhe ndikimin e tyre në klimën e kontinenteve. Secili nxënës plotëson një fletë pune në të cilën ai/ajo përcakton se cilëve breza të nxehtësisë i përkasin kontinentet e dhëna;
- Nxënësit, të ndarë në grupe të vogla, kërkojnë në internet informata rreth florës dhe faunës në zona të ndryshme të nxehtësisë dhe përgatisin video prezantime ose postera për një kontinent të caktuar (për faunën dhe florën tipike të lidhur me zonat e nxehtësisë së kontinentit). Më pas bëjnë një prezantim para të gjithëve dhe së bashku krahasojnë kontinentet e ndryshme;
- Nxënësit, në grupe, shikojnë planetin Tokë në Google Earth dhe vlerësojnë marrëdhënien midis tokës dhe ujit, zbulojnë dhe emërtojnë oqeanet dhe detet më të mëdha dhe përcaktojnë se cilët oqeane/dete rrethojnë kontinentet. Me ndihmën e mësimdhënësit njihen me termin Deti Botëror. Diskutohen karakteristikat e deteve dhe ujit të detit (shija, valët, rrymat detare, baticat, zbatice).
- Nxënësit nëpërmjet prezentimit vizual njihen me formimin e ujërave nëntokësore. Më pas ata diskutojnë lidhjen midis ujërave nëntokësore dhe burimeve;
- Nxënësit, në grupe të vogla, kërkojnë në internet informata mbi pellgjet e lumenjve dhe liqenet më të mëdhenj në botë. Më pas ata ua prezantojnë informacionin të tjerëve dhe i tregojnë në hartën gjeografike lumenjtë dhe liqenet më të mëdhenj në çdo kontinent.

Tema: **CIKLI JETËSOR I BIMËVE ME LULE**

Gjithsej: **12 orë**

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:

1. emërtojë dhe përshkruaj pjesët e lules dhe të shpjegojë funksionin e tyre;
2. emërtojë dhe dallojë fazat e ciklit jetësor të bimëve me lule i cili përfshinë: pluhurimin (pjalminim), pllenimin (frytnimin), formimin e farës, shpërndarjen e farës dhe mugullimin e farës.

Përmbajtjet (dhe nocionet)	Standardet për vlerësim
<ul style="list-style-type: none"> • Pjesët e lules (frut, farë, lule, bisht i lules, shtrat i lules, gjethe të kupës, gjethe të kurorës, thekë, filament i thekut, strajcat e polenit, polen, pistili, gojëza, shtyllëza, vezorja e pistilit, qeliza vezë) 	<ul style="list-style-type: none"> • Emërton dhe përshkruan pjesë të lules; • Shpjegon funksionin e pjesëve të lules (bishti i lules, shtrati i lules, gjethet e kupës, gjethet e kurorës, thekët, filament i thekut, strajcat e polenit, poleni, gojëza, shtyllëza, vezorja e pistilit); • Dallon pjesët mashkullore dhe femërore të lules;
<ul style="list-style-type: none"> • Fazat e ciklit jetësor të bimës (farë, mugullim, fidan, bimë e re, bimë e rritur, pluhurim, pllenim, krijimi i farës, shpërndarja e farës, cikël jetësor, mbështjellës i farës, gjethtëza e farës (kotiledoni), embrioni i farës (filli i bimës së re) , bimë drunore, barishtore, bimë njëvjeçare, bimë shumëvjeçare) 	<ul style="list-style-type: none"> • Njih dhe emërton fazat e rritjes dhe zhvillimit të bimës (fara, mugullimi i farës, fidani, bima e re, bima e rritur); • Shpjegon se pluhurimi (pjalnimi), pllenimi, formimi i farës, shpërndarja e farës dhe mugullimi janë procese që formojnë ciklin jetësor të bimëve; • Identifikon rritjen e bimëve në fazë të caktuar të ciklit jetësor; • Shpjegon procesin e pluhurimit (pjalnimit) dhe dallon bimë të cilat pluhurohen (pjalmohe) me anë të erës (shembull: panjë, luleradhiqe, plep etj.) dhe bimët e pjalmuara nga insektet (shembull: kumbulla, qershia, pema e mollës etj.); • Interpretin procesin e pllenimit dhe bën dallimin midis pluhurimit (pjalnimit) dhe pllenimit; • Emërton pjesë të farave (mbështjellsit e farës, gjethtëza e farës (kotiledoni) dhe embrioni); • Shpjegon procesin e shpërndarjes së farës dhe identifikon mënyra të ndryshme të shpërndarjes së farave të bimët (erë, ujë, spërkatje, kafshë etj.); • Njih dhe krahason lloje të ndryshme të farave; • Krahason karakteristikat në një lloj të caktuar bimor dhe shpjegon se bimët e reja ngjajnë me ato prindërore; • Bën dallimin midis ciklit jetësor të bimëve drunore dhe barishtore (për shembull: lis dhe domate), gjegjësisht bimëve njëvjeçare dhe shumëvjeçare (për shembull: fasule dhe pishë).
<p>Shembuj të aktiviteteve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit njihen me pjesët e lules nëpërmjet një prezantimi vizual. Më pas, të ndarë në grupe të vogla/dyshe, bëjnë një poster me lule (vizatojnë një lule, emërtojnë pjesët e lules dhe prezantojnë posterat e bërë duke përshkruar funksionin e tyre); 	

- Nxënësit, të ndarë në çifte, shikojnë pjesët e një luleje (mund të përdorin edhe xham zmadhues), studiojnë pjesët e një luleje dhe vëzhgojnë pjesët mashkullore dhe femërore të një luleje. (Nxënësit që janë alergjikë ndaj polenit duhet të punojnë në një model lulesh.);
- Nxënësit ndjekin prezentim vizual për rritjen dhe zhvillimin e një bime dhe më pas diskutojnë ndryshimet që kanë vënë re;
- Nxënësit, të ndarë në grupe të vogla/dyshe, nëpërmjet lojës (lidhjes) ose vargut kohor (timeline) identifikojnë fazat e ciklit jetësor të bimës;
- Nxënësit nëpërmjet lojës **Tërheqja e kartelave** (kartelat kanë një figurë të një faze të caktuar) emërtojnë dhe shpjegojnë fazat e ciklit jetësor të bimës dhe i renditin ato sipas rendit të duhur;
- Nxënësit njihen me procesin e pluhurimit (pjalmit) dhe procesin e pllenimit nëpërmjet prezantimit vizual dhe i diskutojnë ato;
- Nxënësit vizatojnë skemën e procesit të pluhurimit me ç' rast paraqesi bartjen e kokrrizave të polenit nga thekët deri te stigma (gojëza) e pistilit;
- Secili nxënës plotëson një fletë pune në të cilën ai/ajo identifikon pjesët e farës (mbështjellësin e farës, gjethtëzën e farës (kotiledonin/et) dhe embrionin) dhe shpjegon funksionin e tyre. Shënim: aktiviteti mund të realizohet me material natyral mirëpo farat duhet parapakisht një ditë përpara të qëndrojnë të zhytura në ujë.
- Nxënësit vëzhgojnë fotografi të polenit (pjalmit) nga bimë të ndryshme dhe vërejnë ndryshime midis kokrrave të polenit. Më pas nëpërmjet **Lojës së bashkimeve** lidhin pamjen e një luleje dhe mënyrën e pluhurimit (me insekte, me erë). Loja mund të mbështetet duke përdorur fletë pune në internet (për shembull: live worksheets);
- Nxënësit, të ndarë në grupe të vogla/dyshe, shikojnë farat e llojeve të ndryshme të bimëve dhe vërejnë dallimet ndërmjet tyre;
- Nxënësit, në dyshe, diskutojnë pse shalqiri dhe bari i keq prodhojnë shumë fara, ndërsa pjeshka dhe qershia nga një farë;
- Nxënësit, të ndarë në grupe të vogla / dyshe / individualisht, bëjnë një koleksion farash dhe nëpërmjet diskutimit zbulojnë lidhjen midis pamjes së farës dhe mënyrës së shpërndarjes (erë, ujë, spërkatje, kafshë);
- Nxënësit, të ndarë në grupe të vogla / dyshe / individualisht, mbjellin farat e bimëve që i njohin (fasule, thjerrëza, kungull, misër, grurë etj.) në dhé të vendosur në kuti vezësh, lëvozhga vezësh, filxhanë etj. dhe pas një kohe vëzhgojnë rritje e bimëve, vërejnë karakteristikat dhe ngjashmëritë e tyre me bimët prindërore;
- Nxënësit, të ndarë në grupe, plotësojnë një fletë pune në të cilën identifikojnë fazat e ciklit jetësor të një bime drunore dhe barishtore (shembull: lisi dhe domate), gjegjësisht, bimët njëvjeçare dhe shumëvjeçare (shembull: fasulja dhe pisha). Në një diskutim të përbashkët, arrijnë të identifikojnë ndryshimet midis njërit cikël dhe ciklit tjetrët jetësor;

Tema: **ORGANIZMAT E GJALLË DHE MJEDISI JETËSOR**

Gjithsej: **10 orë**

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:

1. shpjegojë interakcionin ndërmjet bimëve/kafshëve dhe mjedisit jetësor;

2. shpjegojë marrëdhëniet e ndërsjella midis kafshëve dhe bimëve;
3. identifikojë ndikimet negative të njeriut ndaj mjedisit jetësor dhe pasojat prej tyre.

Nxënësi/nxënësja do të:

